

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Sfidat me të cilat ballafaqohet Agjencia Kosovare e Privatizimit janë të shumta.

Ndryshimi pozitiv është në proces.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është duke përbushur përgjegjësitë dhe angazhimet e saj për të mbështetur ekonominë e Kosovës.

Përmbajtja	Faqe
Deklarata e Kryetarit	3
Përmbledhje	4
Deklarata e Drejtorit Menaxhues	6
Struktura Organizative	7
Privatizimi	8
Likuidimi	12
20% Listat e Punëtorëve	15
Analizë Përmbledhëse	17
Qeverisja Korporative	18
Strategjia	20
Rregullorja, Objektivat dhe Dobitë nga Ndryshimet në Ligjin e AKP-së	21
Rregullorja, Objektivat dhe Dobitë nga Ligji i Ri mbi Riorganizimin	22
Rregullorja, Objektivat dhe Dobitë nga Ndryshimet në Ligjin e OVGJS-së	23
Përfundim	24

Informata për kontakt me AKP-në

Zyra Qendrore e AKP-së

Rr. Ilir Konushevci Nr.8,
10 000 Prishtinë, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org

Zyra Rajonale Prishtinë:

Personi kontaktues: Ekrem Ademi – Kryesues i Zyrës Rajonale
Adresa: Rr. Rexhep Mala Nr. 2, Prishtinë
(afër Riinvest-it)

Zyra Rajonale Pejë:

Personi kontaktues: Ardita Lokaj - Kryesues i Zyrës Rajonale
Adresa: Rr. Vëllëzërit Gërvalla, Objekti Onix Kati I, Pejë
(afër stacionit të trenit)

Zyra Rajonale Prizren:

Personi kontaktues: Nexhat Elshani - Kryesues i Zyrës Rajonale
Adresa: Rr. Pushkatarëve Nr: 9, Prizren
(në Shadërvan)

Zyra Rajonale Mitrovicë:

Personi kontaktues: Muhamedin Hetemi - Kryesues i Zyrës Rajonale
Adresa: Rr. Mbretëresha Teutë, Mitrovicë
(afër qendrës sportive)

Zyra Rajonale Gjilan:

Personi kontaktues: Zeqirja Morina – Kryesues i Zyrës Rajonale
Adresa: Rr. Bujanovci, Gjilan
(Fabrika e Baterive IBG)

Sfidat me të cilat ballafaqohet Agjencia Kosovare e Privatizimit janë të shumta. Shqyrtimi rrënjësor i kornizës ligjore dhe praktikave të punës të Agjencisë kanë shfaqur nevojën për ndryshim rrënjësor. Agjencia dhe ligjet e saj qeverisëse kanë nevojë të ristrukturohen dhe kjo nuk do të ndodh brenda natës mirëpo ndryshimi pozitiv është në proces e sipër.

Performansa e AKP-së në privatizim në përgjithësi ka qenë e suksesshme mirëpo e njëjta nuk mund të thuhet edhe për likuidimin.

Gjatë dy viteve të kaluara, Agjencia dhe shumë nga palët me interes e kanë vënë në dyshim performansën e likuidimit dhe mospësuksin në shpërndarjen e afërsisht €530 milion të fondeve në mirëbesim ndaj kreditorëve dhe pronarëve legjitim dhe përfundimisht Qeverisë së Kosovës. Këto pyetje kanë shtyrë Agjencinë të bëjë shqyrtimin rrënjësor të procesit të likuidimit dhe të bëjë krahasimin e saj me shtetet në rajon së bashku me Parimet e Bankës Botërore për të drejtat efektive të kreditorëve dhe sistemet e josolvensës; me disa rezultate befasese.

Së pari, procesi i likuidimit në Kosovë është dizajnuar për të respektuar kërkesat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës me theks të veçantë në mbrojtjen e interesave dhe drejtave njerëzore të minoriteteve. Rezultati ka qenë një procedurë mjaft komplekse me shtresa për shqyrtim që janë unike për Kosovën lidhur me sistemin e ankesës që ka treguar të jetë jofunksional në praktikë. Padashje, legjislacioni ka funksionuar kundër interesave të cilat është krijuar t'i mbrojtë, duke i mohuar ankuesit të drejtat për t'u paguar dhe duke krijuar vështirësi për punëtorët me drejtë legjitime për skemën e 20%.

Kosova, përkundër shteteve tjera në rajon, në mënyrë të pavarur ka caktuar anëtarët e komisioneve të likuidimit, komisioneve të shqyrtimit, Sekretariatit të Bordit të AKP-së dhe tre anëtarë jo ekzekutiv të Bordit të AKP-së. Ishte bërë e dukshme, që ligji i AKP-së ashtu siç ishte hartuar, në mënyrë të veçantë ishte i papërshtatshëm për të mundësuar likuidim efektiv dhe mundësinë e Agjencisë për të bërë shpërndarjen ndaj punëtorëve në skemën e 20% dhe në mënyrë të pakorrigjueshme i komprometuar nga mungesat në strukturë dhe funksionim të Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme duke mos përmendur mospënjohjen e AKP-së nga ana e Gjykatës për t'i mundësuar

Agjencisë të drejtën për gjykim të drejtë.

Në prill të vitit 2011, Qeveria ka aprovuar gjetjet tona dhe kjo ka rezultuar në shqyrtimin formal të kornizës ligjore të udhëhequr nga Ministria për Zhvillim Ekonomik (MZhE). AKP dhe MZhE ishin të kënaqur që kanë mundësinë për të diskutuar për ndryshimet e propozuara me ministri, komunitetin e donatorëve, Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian (ZNKE), Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtarë (PCN) dhe EULEX-in. Si rezultat i këtij kombinimi të faktorëve, janë përgatitur tri draft-ligje të reja që do të thotë, Ligji i ri i AKP-së, Ligji i ri mbi Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Ligji i rishikuar mbi Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës. Ky proces i ndërlikuar dhe i detajuar ishte paraprirë nga përgatitja e dokumenteve të rregullores për të udhëhequr procesin e hartimit dhe këto janë të bashkëngjitura si shtojca në këtë Raport Special për Palët e Interesit.

Me shpalljen e këtyre ligjeve të reja, AKP-ja do të vazhdojë punën e përafërt me Qeverinë e Kosovës për të ndihmuar më gjerë në ndërtimin e ekonomisë së qëndrueshme. AKP-ja është mirënjohëse për mbështetjen përmes granteve nga ZNKE-ja gjatë tri viteve të fundit dhe shpreson të vazhdojë të ketë këshillat e saj të çmueshme edhe në vitet e ardhshme. AKP-ja është gjithashtu mirënjohëse për mbështetjen e PCN-në, Ambasadës Amerikane dhe USAID-it.

Në përshpejtimin e shqyrtimit të kornizës ligjore të AKP-së, Qeveria ka konfirmuar rëndësinë e Agjencisë për zhvillimin e ekonomisë Kosovare dhe plotësisht përkrah ndryshimet që duhet të ndodhin për të mundësuar finalizimin me kohë të procesit të privatizimit dhe likuidimit. Sfidat me të cilat ballafaqohet AKP-ja janë të shumta. Agjencia dhe ligjet e saja qeverisëse duhet të ristrukturohen dhe kjo nuk do të ndodh brenda natës mirëpo ndryshimet pozitive janë në proces.

Dino Asanaj
Kryetar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së

Përmbledhje


Mandati

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) është organ i pavarur publik (sipas Nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës) që do të ushroj funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën dhe të ketë kompetencë për të ushtruar plotësisht detyrat dhe autoritetin e caktuar me Ligjin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

AKP-ja ka autoritet mbi Ndërmarrjet Shoqërore (NSH-të) duke përfshirë kompetencat për të privatizuar dhe likuiduar ndërmarrjet dhe AKP-ja ushtron këtë autoritet në përputhje me Nenin 159 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Themelimi

Më 30 qershor 2008 AKM-ja ka ndërprerë operacionet përderisa ligji i AKP-së është shpallur më 15 qershor. Mirëpo, është dashur deri në fund të gushtit për përfaqësuesit e AKP-së (me ndihmë të Policisë së Kosovës) për të hyrë në zyrat e ish AKM-së. Jemi befasuar kur kemi zbuluar që i tërë dokumentacioni dhe pajisjet e zyrës ishin zhvendosur kurse në oborrin e zyrës qendrore janë gjetur gjurmë të dokumenteve të djegura përderisa disa shporta ishin të mbushura me dokumente origjinale dhe konfidenciale. Gjithashtu, dokumente mungonin edhe nga pesë zyrat rajonale të ish AKM-së.



Për të gjitha këto janë njoftuar Institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës dhe palët e interesit në atë kohë. Pas kësaj, pajisjet e zyrës dhe dokumentacioni përkatës janë kthyer dhe është dashur deri në fillim të vitit 2009 që AKP-ja të rivendos organizimin dhe të angazhoj tërë stafin.

Është e rëndësishme që operacionet e AKP-së, pasqyrat financiare, financimet e donatorit, fondet në mirëbesim etj. janë audituar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, nga auditime të jashtme të pavarura dhe natyrisht nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të AKP-së. Këto auditime kanë ofruar siguri të nevojshme lidhur me nivelin e transparencës, saktësisë dhe profesionalizmit në Agjenci gjatë ushtrimit të detyrave të saja.

Që nga themelimi i saj, AKP-ja në përputhshmëri të plotë me legjislacionin ekzistues ka raportuar në baza të rregullta pranë Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe palët tjera të interesit nëpërmjet raporteve të punës (Raporti i Punës të AKP-së 2008-2009), nëpërmjet raporteve tremujore dhe në baza vjetore (Raporti Vjetor 2009 dhe 2010) siç është përmbledhur në tabelën më poshtë:

Raportet për autoritetet dhe institucionet përkatëse	Raportet Tremujore	Raportet Vjetore	Raportet Tjera	Viti
AKM (6 vite funksionim)	0	0	0	më herët - 2008
AKP (3 vite funksionim)	2	0	0	2008
	2	0	0	2008
	4	1	1	2009
	4	1	0	2010
	2 – dhe në proces	në proces	në proces	2011
Gjithsej	12 - dhe në proces	2	1	Gjithsej raporte të ndryshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës – 23.

Si shtesë, aktivitetet e Agjencisë janë publikuar në faqen zyrtare elektronike (www.pak-ks.org), ku janë vënë në dispozicion për publikun dhe media informata mbi valët e privatizimit, shitjet me likuidim dhe listat e punëtorëve për 20%. Faqja elektronike gjithashtu përfshin hollësi mbi ligjet qeverisëse, rregulloret dhe rregullat e tenderit. Gjithashtu ekziston pjesa me informata mbi Bordin e Drejtorëve, mundësi për punësim, prokurimin dhe raportet e lëshuara nga Agjencia. Si zakonisht me shumë faqe tjera elektronike, përmban informata për Kosovën, raporte dhe komunikata për shtyp dhe linqet e dobishme për faqe tjera elektronike.

Ne jemi të vendosur që të bëjmë gjithçka për të bërë ndryshimet; të rindërtojmë themelet dhe të përforcojmë mundësinë e Agjencisë për të finalizuar likuidimet gjatë pesë viteve të ardhshme dhe nëpërmjet privatizimit dhe likuidimit të suksesshëm të rivendosim besimin e palëve të interesit në organizatë dhe të kontribuojmë në ndërtimin e sektorit të suksesshëm dhe qëndrueshëm privat në Kosovë.

Periodha trevjeçare prej themelimit të AKP-së ka qenë e vështirë. Duke filluar në qershor 2008 pa pranim-dorëzim nga paraardhësi (AKM) dhe dëshmi për përpjekjet për t'i shkatërruar shënimet dhe dokumentet në oborrin e selisë qendrore, është dashur deri në fillim të vitit 2009 për të rigjetur shënimet dhe pajisjet e zyrës dhe për të angazhuar personelin. Nevoja e caktuar ligjërisht për të patur përfaqësues të pavarur në të gjitha organet kryesore të likuidimit në mënyrë efektive ka ndërprerë likuidimin gjatë vitit 2009 dhe pjesën e parë të vitit 2010 për shkak të vonësive në emërimin apo caktimin e të emëruarve.

Ndërkohë, palët e interesit kërkonin që AKP-ja të përbushë përgjegjësitë e veta dhe ballafaqohej me kërkesa për shpërndarjen e fondeve (sidomos nga punëtorë protestues). Agjencia gjithmonë është munduar të plotësoj zotimet e veta për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat në Kosovë nëpërmjet privatizimit dhe shitjes së asetëve të mbetura me likuidim. Agjencia ka kryer përafërsisht 60% të privatizimit mirëpo likuidimi i 600 Ndërmarrjeve Shoqërore është në fazën e hershme dhe Agjencia nuk ka patur ndihmë për shkak të trashëgimit të metodologjisë defektive nga AKM-ja; të fundit iu është dashur një vit zhvillim institucional për të bërë korrigjimet me ndihmë të mbështetjes teknike të financuar nga ZNKE-ja.

Gjatë gushtit 2011, Agjencia është ngarkuar me një kornizë të ndërlikuar ligjore e cila merrte kohë shumë dhe është munduar të arrijë progres në lidhje me likuidimet. Gjithashtu ka pësuar nga kundërshtimet e pandërprera nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB i cili insistonte të ketë drejtën e vetme për të përfaqësuar AKM-në në gjykatë, një qëndrim i cili është mbështetur nga Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës (OVGJS).

Si pjesë e zotimit tonë ndaj qeverisë dhe popullit të Kosovës, Agjencia ka themeluar skemën për 'shpërndarjen e parakohshme' për të lehtësuar vështirësitë e krijuara ndaj

punëtorëve me të drejtë për 20% dhe janë paguar afërsisht €42 milion. Mirëpo akoma ka shumë punë për t'u kryer me €60 milion të mbetura për t'u paguar dhe kjo është duke u vonuar nga procedura e ngadaltë e vendimeve të OVGJS-së mbi listat e kontestuar. Vjeshtën e kaluar, Agjencia ka përfunduar hapjen e zyrave satelitore në tri enklavat që menaxhohen nga personeli vendor dhe jemi duke arritur sukses për të ofruar shërbimet e privatizimit dhe likuidimit me një mjedis të vështirë politik.

Si pjesë e planit tonë afatgjatë, struktura organizative dhe ekipi i menaxhmentit do të ristrukturohen gjerësisht për të pasqyruar prioritetet e rishikuara dhe për të përshtat AKP-në me pikësynimin.

Një nga prioritetet është të sigurohet që mësimet e marra nga shqyrtimi i kornizës ligjore të përshtaten në zhvillimin e politikave dhe procedurave të reja dhe të kontribuojë në një rindërtim gjithëpërfshirës se si Agjencia e drejton likuidimin.

Me kalimin e kohës, Agjencia do të bëhet një organizatë më e vogël me mandat të qartë të përfundimit të punës. Sa më shpejtë që të përfundojë privatizimi dhe likuidimi aq më e shpejtë do të jetë rritja dhe zhvillimi i sektorit privat.

Ne jemi të vendosur për të bërë gjithçka për të bërë ndryshimet; të rindërtojmë themelet dhe të përforcojmë mundësinë e Agjencisë për të finalizuar likuidimet gjatë pesë viteve të ardhshme dhe nëpërmjet privatizimit dhe likuidimit të suksesshëm të rivendosim besimin e palëve të interesit në organizatë dhe të kontribuojmë në ndërtimin e sektorit të suksesshëm dhe qëndrueshëm privat në Kosovë.

Shkelzen Lluka
Drejtore Menaxhues

Struktura Organizative

Struktura organizative e AKP-së, siç parashihet me Ligjin e AKP-së përbëhet nga katër pjesë funksionale: Bordi i Drejtorëve të AKP-së si organ vendimmarrës dhe më pas pjesa ekzekutive e Agjencisë që përbëhet nga Divizioni për Shitjen e Aseteve (RA), Divizioni i Qeverisjes Korporative (QK) dhe Dega Ekzekutive nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të menaxhmentit të Agjencisë përderisa Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publik raporton drejtpërdrejtë tek menaxhmenti i Agjencisë dhe për çështje specifike tek Bordi i Drejtorëve.

Struktura e AKP-së

Bordi i Drejtorëve

Drejtori Menaxhues

Divizioni i RA

Privatizimi + Likuidimi

Divizioni i QK

Kontrolli dhe Mbikëqyrja,
Monitorimi, Administrimi
Direkt dhe Trepça

Rajonal

5 Zyret Rajonale: Prishtinë,
Mitrovicë, Gjilan, Prizren, Peja

3 Zyra Satelitore: Leposavic,
Gracanica, Strpce

Departamenti Ligjor,
Auditimi, Administrata,
Resurset Njerëzore

Struktura më lart do të ndryshohet për të pasqyruar ligjin e ri të AKP-së dhe struktura e shqyrtuar do të vendoset deri në fund të 2011.

Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi institucional

Që nga themelimi, AKP-ja ka hyrë në marrëveshje të rëndësishme (të formalizuara nëpërmjet Memorandumeve të Mirëkuptimit) me disa institucione të Kosovës siç janë:

- Ministria e Punëve të Brendshme (Kontrolli i historikut të investitorëve)
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (ndryshimet në Regjistrin e Biznesit vetëm me aprovimin e AKP-së)
- Ministria e Shërbimeve Publike (Shfrytëzimi i pronës të NSH-së nga institucionet e Kosovës)
- Banka Qendrore e Kosovës (Afatet dhe Kushtet për mirëmbajtjen e Fondeve në Mirëbesim)
- Administratën Tatimore të Kosovës (Transferi i detyrimeve tatimore tek investitorët dhe tatimimi i NSH-së).

Përfundimisht duhet cekur që shpallja e Ligjit Nr. 03/L-226 mbi alokimin për shfrytëzimin dhe transferimin e paluajtshmërisë të Komunës ka qenë bazë me ndikim pozitiv në raportet ndërmjet AKP-së dhe komunave në drejtim të qëllimit të përbashkët për përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve të Republikës së Kosovës. Qëllimi kryesor i ligjit është përcaktimi i procedurave në bazë të cilave komunat mund të alokojnë pronën e tyre të paluajtshme ndaj personave të tretë **si dhe përcaktimin e procedurave që mundësojnë shkëmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronë të paluajtshme të Ndërmarrjeve Shoqërore nën administrimin e AKP-së për qëllime të përfitimit publik.**

Privatizimi

Privatizimi ka qenë një proces që vazhdon që nga viti 2002 dhe përmbledhja është dhënë më poshtë:

Ekzistojnë 600 NSH në regjistrin e AKP-së. Përafërsisht 400 prej tyre konsiderohen të kenë biznes me mundësi për sukses apo kanë asete që janë të përshtatshme për privatizim kurse 200 tjera do të trajtohen me proces të likuidimit.

Deri më sot afërsisht 300 NSH janë privatizuar plotësisht apo pjesërisht nëpërmjet krijimit të 619 Ndër.të Reja dhe 175 shitje me likuidim të aseteve të ndryshme janë realizuar me sukses. Prandaj me të drejtë mund të thuhet që me disa përjashtime, shumica e NSH-ve të mëdha tashmë janë privatizuar dhe i tërë privatizimi është në proces të përfundimit.

Gjatë mandatit të AKM-së, metodat e përdorura për shitjen e aseteve me privatizim janë quajtur Spin Ofe të Rregullta (SOR), Spin Ofe të Kushtëzuara (SOK), Spin Ofe Speciale (SOS) dhe në fund shitja me likuidim.

Përderisa SOR nuk kishte kushte përpos çmimit më të lart të ofruar i cili përcaktonte ofertën fituese dhe zhvillohej në një xhiro ofertuese, SOK dhe SOS përpos çmimit më të lart (50% e pikave), oferta fituese përcaktohej bazuar në zotimin për punësim (25% e pikave) dhe zotimin për investime (25% e pikave) të ofruara nga ofertuesit dhe si shtesë ekzistonin dy xhiro të ofertimit ku xhiroja e dytë e ofertimit përfshinte vetëm tre ofertuesit më të lart nga xhiroja e parë.

AKP-ja ka vazhduar me SOR për shitjen e aseteve që dmth fituesi është përcaktuar nga çmimi më i lart i ofruar, në një xhiro mirëpo në raste të veçanta AKP-ja mund të kërkojë ekspertizën përkatëse nga ofertues potencial dhe në sektorë specifik siguri të arsyeshme në lidhje me suksesin e privatizimit të tillë.

Aq më tepër, AKP-ja ka aplikuar rregullin që në rast të tërheqjes së ofertuesit fitues, përpos konfiskimit të depozitës për ofertë (në rast mospërbushje) Ndër.e Re do t'i ofrohet ofertuesit të dytë apo të tretë vetëm nëse pajtohen të ofrojnë çmimin e parë

të ofruar fillimisht nga ofertuesi fitues.

Ky rregull ka ndihmuar në parandalimin e mospërbushjeve që janë paraqitur në valët fillestare të privatizimit në AKM. Kjo gjithashtu ndihmon në eliminimin e marrëveshjeve të fshehta dhe detyrimeve gjatë procesit të ofertimit. Çdo ofertë fituese, para përfundimit të shitjes i nënshtrohet kontrollit të përafërt nga njësitë e specializuara të Policisë brenda procedurës së kontrollit të historikut.

Një iniciativë tjetër e AKP-së ka qenë hapja e Zyrave Satelitore në Leposaviq, Shtërpce dhe Graçanicë. Kjo ka rezultuar në privatizimin e disa NSH-ve dhe aseteve të tyre në komunat veriore të Republikës së Kosovës. Si rezultat i kësaj, AKP-ja është bërë një nga institucionet e Republikës së Kosovës që ka vendosur dhe ushtruar autoritetin dhe mandatin e vet në tërë territorin administrativ të Republikës së Kosovës.

Me vendosjen e administratës së Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në vitin 1999, misioni i UNMIK-ut ka vendosur qiradhënie 10 vjeçare (komercializim) për disa Ndërmarrje Shoqërore të rëndësishme nga aspekti strategjik. Deri tani, nga 18 marrëveshje për komercializim, mbetet vetëm një, që është Fapoli në Podujevë, përderisa marrëveshjet tjera të komercializimit janë zgjidhur apo ato NSH dhe asetet e tyre iu janë nënshtruar privatizimit.

Një komercializim i rëndësishëm, rasti i Sharr Cementit, iu është nënshtruar privatizimit që është realizuar me sukses në dhjetor të vitit 2010. Marrëveshja për komercializim i ka dhënë qiramarrësit të drejtën për të blerë fabrikën me çmim të tregut dhe kjo ka obliguar Agjencinë të hyjë në negociata të drejtpërdrejta me qiramarrësin, Titan Group. Agjencia ka caktuar këshilltarë ndërkombëtarë për transaksion për të ndihmuar në negociata dhe çmimi i arritur prej €30.1 milion ishte më i larti sipas vlerësimit të këshilltarëve për transaksion. Si shtesë, blerësi është zotuar për investime kapitale shtesë që arrijnë shumën prej €35 milion për 5 vite dhe ka garantuar punën e të gjithë punëtorëve aktual për 3 vitet e ardhshme.

Gjatë periudhës gjashtë vjeçare të ekzistencës së saj, AKM-ja ka realizuar 30 valë të privatizimit që kanë rezultuar në 418 Ndër.të Reja dhe 36 shitje me likuidim. Në krahasim, prej 19 nëntor 2008 (më pak se tri vjet) AKP-ja ka realizuar 22 valë të privatizimit që kanë rezultuar në shitje të suksesshme të 201 Ndër.të Reja dhe 139 shitje me likuidim. Totali i kombinuar arrin shumë prej 794 kontrata (SOS, SOK, SOR dhe shitjet me likuidim) siç është përshkruar në tabelën më poshtë:

Që nga themelimi i AKP-së në gusht 2008, AKP-ja, në disa raste, ka kërkuar shpjegime nga BQRK për politikat e sigurisë dhe procesin vendimmarrës në lidhje me fondet në mirëbesim dhe në veçanti tarifat jashtëzakonisht të ulëta të kamatës (0.1% kamatë vjetore) në atë kohë.

Për të zgjidhur këtë çështje, AKP-ja ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit (MM) me BQRK në

Kontratat e nënshkruara nga AKM-ja gjatë 6 viteve – gjithsej 30 valë të privatizimit			
Nr.	Metodi i Shitjes	Nr. i kontratave të nënshkruara	€ Vlera e kontratave të nënshkruara
1	Spin Of Special	24	91,723,495
2	Spin – of	381	244,556,961
3	Spin Of	13	15,358,885
4	Likuidim	36	4,293,164
	Nën-totali	454	355,932,505
Kontratat e nënshkruara nga AKP-ja gjatë 3 viteve – gjithsej 22 valë të privatizimit			
Nr.	Metodi i Shitjes	Nr. i kontratave të nënshkruara	€ Vlera e kontratave të nënshkruara
1	Spin Of Special	1	103,000
2	Spin – of	199	144,601,634
3	Spin Of	1	335,000
4	Likuidim	139	27,662,116
	Nën-totali	340	172,701,750
Gjithsej Kontrata të Nënshkruara nga AKM / AKP – në gjithsej 52 valë të privatizimit			
Nr.	Metodi i Shitjes	Nr. i kontratave të nënshkruara	€ Vlera e kontratave të nënshkruara
1	Spin Of Special	25	91,826,495
2	Spin – of	580	389,158,595
3	Spin of i kushtëzuar	14	15,693,885
4	Likuidim	175	31,955,280
	GJITHSEJ AKM / PAK	794	528,634,255

Siç mund të shihet më lart, shitjet me privatizim dhe likuidim deri më sot kanë dhënë € 528,6 milion dhe 20% e kësaj është caktuar për punëtorë të cilët kualifikohen për skemën e 20%. Atëherë kur të përfundoj privatizimi i NSH-së, hapi tjetër është shitja e asetëve të mbetura dhe më pas nëpërmjet likuidimit trajtimi i ankesave të kreditorëve dhe pronarëve.

Ndërkohë, derisa të përfundoj likuidimi, të hyrat nga privatizimi dhe likuidimi mbahen në mirëbesim në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQRK). Këto fonde në mirëbesim gjithashtu përfshijnë të ardhurat nga privatizimi dhe likuidimi të kryera nga Agjencia paraardhëse (AKM-ja).

gusht 2010 që kryesisht rregullon raportet ndërmjet AKP-së dhe BQRK-së në lidhje me sigurinë dhe investimet e fondeve në mirëbesim. Si rezultat, një pjesë e konsiderueshme e fondeve në mirëbesim të mbajtura në llogari rrjedhëse janë transferuar në depozita me afatizim më rekomandim të BQRK-së dhe në përputhje me politikat e saj financiare dhe bankare.

Pas MM dhe implementimit të rekomandimeve të BQRK-së, interesi i fituar tashmë është përafërsisht 8 (tetë) herë më i lart (apo përafërsisht € 5 milion më shumë) se sa ajo që do të ishte nëse fondet në mirëbesim do të mbeteshin në llogari rrjedhëse.

Privatizimi i Tokës Bujqësore

AKP-ja vazhdon me privatizimin e tokës bujqësore me destinim të caktuar më herët. AKP-ja nuk mund të ndryshoj destinimin e sipërfaqeve të caktuara tokësore dhe kjo është e cekur qartë në të gjitha materialet e privatizimit për shkak se autorizimet e tilla i takojnë Kuvendeve Komunale (Ligji mbi Tokën Bujqësore Nr.02/L-26 dhe gjithashtu i rregulluar sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe Ligji për Mbrojtjen e Ambientit).

Tabela në vijim tregon që në fillim gjithsej portfolio e tokës e lënë në besim të AKM / AKP-së ishte 46, 145 hektarë prej të cilave AKM-ja ka shitur 23,930 hektarë. SDeri tani, AKP-ja ka shitur 4,912 hektarë. Sa i përket

Statusi	Hektar	%
Shitur nga AKM	23,930	52%
Shitur nga AKP	4,912	11%
Shitur me likuidim	265	1.6%
Për t'u shitur	17,038	35.4%
Gjithsej	46,145	100%

shitjes, katër transaksione me gjithsej 543 hektarë ishin në të vërtetë ri-oferta të ngastrave të tenderuara nga AKM-ja dhe për të cilat janë refuzuar ofertat. Pavarësisht, praktika e fundit ka treguar që AKP-ja ia ka arritur të dyfishojë disa nga ofertat e mëparshme.

Thënë shkurt, portfolio e mbetur prej më shumë se 17,000 hektarë tokë për t'u shitur është e shpërndarë në afërsisht 90 NSH. Kjo megjithatë është në vete një fotografi mashtruese ku sipas analizave: prej përtëj 17,000 hektarë të mbetur, afërsisht 75% apo më shumë se 12,000 hektarë i takojnë shtatë NSH-ve përderisa 24% apo më shumë se 4,000 hektarë janë të kontrolluara nga nëntë NSH duke lënë pjesën e mbetur të balancit prej afërsisht 1% duke qenë ngastra më

të vogla të tokës të më shumë se 70 NSH.

Me fjalë tjera, procesi i shitjes së tokës së NSH-ve në Kosovë ishte realizuar në masë të madhe nga AKM-ja me pjesën e mbetur të portfolios që përbën ndërmarrjet themelore, shitja e të cilave kërkon zgjidhjen e problemeve të vështira ligjore dhe tjerë. Ia vlen të ceket që pavarësisht nga çështjet e tranzicionit, proceset dhe procedurat e përdorura nga AKP-ja janë trashëguar nga AKM-ja dhe besohet që pasqyrojnë praktikën më të mira ndërkombëtare (siç duket ato janë zhvilluar nga specialistët ndërkombëtarë të mbështetur nga Konsulent Ndërkombëtarë).

Sa i përket komenteve që shitja e ngastrave të mëdha mund të çojë tek rezultatet e dobëta, nuk ka dëshmi reale, posaçërisht atëherë kur marrim parasysh që ngastrat e vogla janë të paqëndrueshme për bujqësi dhe si të tilla paraqesin shitje të paluajtshmërisë. Aq më tepër, sipas analizave të bëra nga AKP-ja në lidhje me vlerën e tokës, indikacionet bazuar në rezultate deri më sot, tregojnë që AKP-ja ka dyfishuar çmimin mesatar të tokës së shitur në krahasim me AKM-në. Duke e thënë këtë AKP-ja ia ka arritur të ngrit performancën në krahasim me AKM-në ashtu siç e paraqet edhe tabela përderisa mesatarja e përgjithshme e çmimit të tokës në Kosovë tregon një trend të rritjes dhe çmimet e arritura janë të admirueshme.

GJITHSEJ TOKË E SHITUR NË AKM / AKP				
Madhësia e Ngastrës në Hektarë	Nr i Ngastrave	Gjithsej Hektarë	Çmimi i paguar	Çmimi mesatar për Hektarë
<5	133	91	20,390,616 €	224,188 €
>5<10	11	82	3,803,354 €	46,513 €
>10 <100	85	4,294	26,786,851 €	6,238 €
>100<500	66	14,003	34,360,799 €	2,454 €
>500<1000	4	3,009	3,501,090 €	1,163 €
<1500	2	2,346	5,398,332 €	2,301 €
<2500	1	2,200	4,302,900 €	1,956 €
GJITHSEJ	302	26,025	98,543,942 €	gjith/ mes/pri/he 3,786 €

Duke ecur përpara, AKP-ja do të përqendrohet në strategjinë e saj për të realizuar detyrat e privatizimit dhe likuidimit duke përfshirë tokën bujqësore.

Trepça

Trepça është një konglomerat me asete dhe degë që ndodhen pothuaj në të gjitha rajonet e vendit duke përfshirë pjesën veriore të Republikës së Kosovës. Pasuria e saj minerare që mund të nxirret ka qenë temë e debateve të nxehta me opinione të ekspertëve për vlerësime që sillet prej €8 deri €12 miliardë. Në ish Jugosllavi, kjo ishte një ndër punëdhënësit më të mëdhenj me më shumë se 20,000 punëtorë. Trepça përbëhet nga 40 ndërmarrje vartëse që përfshinë komponentët e saja minerare dhe metalurgjike, kapacitete përpunuese dhe produkte tjera industriale si dhe aktivitete mbështetëse për prodhim, përpunim dhe mbështetje teknike. Shumica e këtyre janë në territorin e Republikës së Kosovës mirëpo gjithashtu edhe jashtë. Prandaj, padyshim Trepça ka rëndësi të jashtëzakonshme për Republikën e Kosovës dhe qytetarët e saj dhe është mjaft e rëndësishme për ekonominë, shoqërinë dhe politikën e vendit dhe vërtet edhe për disa nga fqinjët e saj.

Konglomerati Trepça nuk kishte imunitet ndaj ndërhyrjeve politike dhe masave të dhunshme gjatë regjimit të Millosheviqit dhe palët me “ankesa” kundër aseteve filluan të lajmërohen që ka rezultuar në ndërprerjen e funksionimit si rezultat i ‘moratoriumit’ të caktuar nga OVGJS-ja pas kërkesës së PSSP të UNMIK-ut. Në nëntor 2005, UNMIK-u lëshon një Rregullore (2005/48) mbi Riorganizimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve të caktuara. Duke përfituar njohuri nga ngjarjet, është e qartë që 2005/48 është më pak se ideale, nëse përdoret, do të rezultonte në kontrollin e fatit të Trepçës duke e lënë në duart e administratorit të sektorit privat. Si pasojë, 2005/48 është zëvendësuar me ligjin e ri mbi riorganizimin që do të sigurojë që riorganizimi i Trepçës të menaxhohet dhe kontrollohet nga Agjencia në të mirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Agjencia do të ketë kompetenca për të angazhuar shërbimet e ekspertëve ndërkombëtarë për miniera dhe josolvençë për të dizajnuar planin e riorganizimit që do të jetë më i përshtatshmi për këtë ndërmarrje komplekse së bashku me ekspertët e specializuar ligjor për t’i trajtuar ankesat.

Agjencia mbetet e bindur që çdo plan për revitalizimin e Trepçës duhet të ndodh sa më shpejt që të jetë e mundur mirëpo duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare në lidhje me ri-organizimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve strategjike. Kjo do të kërkojë angazhim të konsiderueshëm të të gjithë palëve të interesit për shkak se revitalizimi i suksesshëm i Trepçës kryesisht nënkupton që ndërmarrja duhet të lirohet nga problemet e trashëguara dhe të përparoj përsëri.

Brezovica

Qendra Turistike Brezovica ndodhet në Shtërpce, komunë në këndin jugperëndimor të rajonit të Gjilanit dhe ski liftet e saj shkojnë tek kufiri me Republikën e Maqedonisë deri në jug.

NSH Qendra e Skijimit Brezovica është qendra e vetme e turizmit dimëror në Kosovë që ka kushte të jashtëzakonshme natyrore për skijim. Aktualisht Ndërmarrja punëson 225 njerëz të cilët kryesisht punojnë në objekte hoteliere. Për shkak të faktit që objektet e ngjashme nuk ekzistojnë në Kosovë, Brezovica nuk ka ndonjë konkurrent të rëndësishëm në turizmin dimëror. Brezovica i ka të gjitha kushtet për t’u bërë njëra nga qendrat më të mira të rekreacionit / skijimit në këtë pjesë të Ballkanit. Ajo ofron pamje atraktive në malet e Sharrit dhe ofron kushte të shkëlqyeshme klimatike që mundësojnë skijimin prej muajit nëntor deri në maj.

Mirëpo Brezovica ka nevojë për investime të konsiderueshme dhe planifikim të kujdesshëm. Agjencia në bashkëpunim të përafërt dhe me përkrahjen e ZNKE-s në Kosovë ka përgatitur planin për zhvillim dhe zgjerim të ardhshëm në këtë rrethinë dhe aktualisht është duke planifikuar hapat e nevojshëm para-privatizimit.

Likuidimi

Janë 600 NSH nën mandatin e AKP-së dhe të gjitha do t'i nënshtrohen likuidimit pasi që kjo është mënyra e vetme ligjore në dispozicion për të identifikuar kreditorët dhe pronarët me drejtë në të ardhura nga privatizimi dhe asetëve të shitura gjatë procesit të likuidimit.

AKM-ja ka filluar 120 likuidime mirëpo nuk ka mundur t'i përfundojnë për disa arsye mirëpo si shkaktarë i rëndësishëm ka qenë mungesa e metodologjisë të likuidimit dhe proceseve esenciale të menaxhimit të likuidimit. AKP-ja ka filluar 59 likuidime dhe ka filluar një sërë të shitjeve me likuidim. Është e qartë që programi i likuidimit është në një fazë fillestare me vetëm dy likuidime të realizuara në momentin e këtij raporti.

Në përgjithësi, likuidimi mund të ndahet në tri komponente; realizimi i asetëve, ankesat dhe shpërndarja e fondeve ndaj kreditorëve legjitim dhe teprica do të shkojë në Buxhetin e Kosovës. Mirëpo pjesa që më së shumti merr kohë janë ankesat. Një diagram që paraqet kohëzgjatjen e likuidimit në përputhje me ligjet ekzistuese është dhënë në fund të kësaj pjese të raportit. Nga diagrami mund të shihet që kohëzgjatja minimale është 42 muaj (në praktikë kjo është më e gjatë kur paraqiten vonesa që janë jashtë kontrollit të Agjencisë – siç janë vonesat në Gjykatë). Është vlerësuar që efekti i kombinuar i ndryshimeve në Ligjin e AKP-së dhe OVGJS-së do të rezultojë në zvogëlim prej 42 muajve në më së shumti 20 muaj.

Është e qartë që likuidimet kanë marr shumë kohë dhe ecuria jashtëzakonisht e ngadalshme e përmbylljes së rasteve është deshtë të regullohet. Vlerësime të ndryshme bazuar në legjislacionin dhe praktikën ekzistuese kanë treguar që do të nevojiteshin 18 deri 20 vite për të përfunduar procesin e likuidimit me një kosto prej mbi € 100 milion.

Agjencia ka ekzaminuar të gjitha pjesët e operimeve dhe ka bërë krahasimin e Ligjit dhe Rregulloreve të Kosovës me vendet e tjera në rajon. Ky shqyrtim gjithashtu ka konsideruar Parimet e Rekomanduara nga Banka Botërore për të Drejtat e Kreditorëve Efektiv dhe Sistemet e Josolvencës dhe vëmendje e veçantë iu është dhënë procedimit dhe pagesës së ankesave (që është komponent e të gjitha sistemeve të josolvencës që më së shumti merr kohë).

Nga ky shqyrtim është bërë e qartë që mungesat në disa sfera janë duke i kontribuar problemeve në

Kosovë. Gjithashtu, ekzistonin faktorë të brendshëm dhe të jashtëm që ndikonin në rezultate dhe të gjitha duhej trajtuar nëse dëshirohej të gjindej zgjidhja.

Së pari, procesi i likuidimit në Kosovë ishte dizajnuar për të respektuar kërkesat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës me theks të veçantë në mbrojtjen e interesave dhe drejtave njerëzore të minoriteteve. Rezultati ishte një procedurë mjaft e ndërlikuar me shtresa për shqyrtim që janë të veçanta për Kosovën në lidhje me sistemin e ankimit që ka treguar të jetë jofunksional në praktikë. Padashje, legjislacioni ka funksionuar kundër interesave të cilat është krijuar t'i mbrojë, duke i mohuar ankuesit të drejtat për t'u paguar dhe duke krijuar vështirësi për punëtorët me drejtë legjitime për skemën e 20%. Kosova, kundrejt shteteve tjera në rajon, në mënyrë të pavarur ka caktuar anëtarët e komisioneve të likuidimit, komisioneve të shqyrtimit, Sekretariatit të Bordit të AKP-së dhe tre anëtarë jo ekzekutiv të Bordit të AKP-së. Ishte bërë e dukshme, që ligji i AKP-së ashtu siç ishte hartuar, në mënyrë të veçantë ishte i papërshtatshëm për të mundësuar likuidim efektiv dhe mundësinë e Agjencisë për të bërë shpërndarjen ndaj punëtorëve në skemën e 20% dhe në mënyrë të pakorrigjueshme e komprometuar nga mungesat në strukturë dhe funksionim të Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme duke mos përmendur mosnjohjen e AKP-së nga ana e Gjykatës për t'i mundësuar Agjencisë të drejtën për gjykim të drejtë.

Në Kosovë, vendosja në instancë të parë nëse një ankesë do të pranohet apo refuzohet i takon Komisionit të Likuidimit (KL). Ankesën e refuzuar, ankuesi mund të dërgoj tek Komisioni i brendshëm i AKP-së për Shqyrtimin e Likuidimit (KSHL) që udhëhiqet nga i emëruari i ZCN-së. Nëse ankuesi nuk është i kënaqur me vendimet e KSHL-së, ankuesi kishte të drejtën të parashtrij ankesën pranë OVGJS-së dhe më pas, brenda saj, OVGJS-ja ka edhe një procedurë të ankimit. Me fjalë tjera, ankesat do kalonin nëpër katër vlerësime para se të merret vendimi përfundimtarë. Në krahasim, shumica e juridiksioneve ofrojnë një vendim që përbëhet prej dy fazave, e para që bëhet nga likuidatori dhe e dyta nga Gjykatat. Përfundimisht, ankesa përfundimtare mund të dërgohet tek Gjykata Kushtetuese për çështjet lidhur me drejtat njerëzore.

Struktura e KL-së dhe KSHL-së nuk funksiononte dhe ankesat shpeshherë nuk njoftoheshin për vendimet. Në disa raste, ankesat janë refuzuar për shkak se nuk janë parashtruar në gjuhën angleze! Ishte mjaft e qartë që mund të paraqiten ndryshime që do të përshpejtonin procesin e ankesave, shpërndarjen e fondeve dhe përmbylljen e rasteve të likuidimit pa komprometuar përgjegjësitë dhe transparencën mirëpo këto ndryshime do të jenë të mundshme me paraqitjen e strukturave të reja.

Ligji i ri i AKP-së parasheh zëvendësimin e strukturës së KL-së dhe KSHL-së me Autoritetet e Likuidimit (AL) të mbështetur nga paneli i firmave profesionale që do të paguhen sipas rezultateve të procedimit të ankesave dhe realizimit të likuidimeve. Të emëruarit e ri do të përzgjidhen bazuar në përvijën dhe aftësinë për të ofruar shërbimet e kërkuara. Do të përpilohet Kontrata mbi Kornizën (KK) për të lehtësuar këtë marrëveshje dhe kontraktorët do të

raportojnë tek AKP-ja e cila do të menaxhojë realizimin dhe aprovimin e punës.

Agjencia ka besim që ligji i ri i AKP-së do të ofrojë kornizën ligjore që është në përputhje me Parimet e Rekomanduara të Bankës Botërore për Drejtat e Kreditorëve Efektiv dhe Sistemet e Josolvensës. Kjo kornizë e re ligjore do të përshpejtojë procedimin e ankesave dhe minimumi prej 42 muajve të nevojshme për të proceduar një ankesë sipas ligjit të vjetër të AKP-së do të zvogëlohet në më së shumti 20 muaj. Nuk ka shënime statistikore mbi modelin e shpërndarjes ndaj kreditorëve dhe pronarëve. Megjithatë, analiza vjetore e Afarizmit të Bankës Botërore tregon një sërë ndërmjet 2 dhe 3.3 vite për të realizuar një likuidim për 8 vende në rajon.

Zvogëlimi i kohëzgjatjes do të ishte mjaft i dobishëm për kreditorët, pronarët dhe ekonominë Kosovare. Aktualisht AKP-ja mban afërsisht € 530 milion në fonde në mirëbesim që janë të destinuar për ankesat legjitime dhe kjo përfshin buxhetin e Kosovës ku do të shkojë tepër nga likuidimi.

Diagrami në vijim është një listë që paraqet hapat e nevojshëm për të realizuar likuidimin sipas ligjeve ekzistuese. Ligji i Ri i AKP-së i kombinuar me ligjin e ri të OVGJ-së ka për qëllim zvogëlimin e kohës prej 42 muaj në më së shumti 20 muaj.

PROCESI I LIKUIDIMIT DHE SHQYRTIMI ANKESAVE

Ne baze të ligjit të AKP-se, Politikave Operacionale të AKP-se, Rregulloretve të UNMIK-ut për OVGJ 2008/4, 2008/19 dhe Urdheresën Administrative 2008/6

Nr	Faza	Trupi kontrollues	Hapi	Referenca	Numruesi				
					Ditët e operimit	Ditët e skumës që nga fillimi	% e përfunduar (dite)	Ditët dhe % për të përfunduar (Dite)	
1	Likuidimi	Komisioni i Likuidimit ("KL") (1 anetar i ICO)	1	Vendimi i Bordit për likuidim të NSh	0	0	0%	1,264	100%
			2	Njoftimi për likuidim të Regjistrimit të Bizneseve	5	5	0%	1,259	100%
			3	Njoftimi me l shkurte për shitjen e aseteve	30	35	3%	1,229	97%
			4	Shqyrtimi i të dhënave dhe librave të NSh	0	35	3%	1,229	97%
			5	Inventarizimi i aseteve	0	35	3%	1,229	97%
			6	Njoftimi të gjithë kreditorëve të njohur	0	35	3%	1,229	97%
			7	Percaktimi i metodës së shitjes	0	35	3%	1,229	97%
			8	Shpallja e likuidimit - shpallja 1	0	35	3%	1,229	97%
			9	Shpallja e likuidimit - shpallja 2	0	35	3%	1,229	97%
			10	Publikimi i listës së aseteve për shitje	0	35	3%	1,229	97%
			11	Njoftimi i gjykatave për suspendim të veprimeve ligjore	0	35	3%	1,229	97%
			12	Ankesat të shqyrtohen brenda 60 ditëve nga shpallja e pare	60	95	8%	1,169	92%
			13	Organizimi i shitjes së aseteve	0	95	8%	1,169	92%
			14	Vlerësimi i kërkesave të kreditorëve nga KL	30	125	10%	1,139	90%
			15	Njoftimi i KL ndaj kreditorëve mbi vlerësimin e kërkesave të tyre	5	130	10%	1,134	90%
			16	Ankesa e kreditorëve ndaj vlerësimit të KL	60	190	15%	1,074	85%
			2	Apeli 1 (i brendshëm)	Komiteti për Shqyrtim të Rasteve të Likuidimit ("KSRL") - Kryesuar nga ICO	17	KSRL shqyrtimi i vlerësimit të KL	60	250
18	Koha e lejuar për KSRL	30				280	22%	984	78%
19	Njoftimi për vendimin e KSRL	14				294	23%	970	77%
20	Njoftimi nga KSRL në rast të kthimit të vendimit	14				308	24%	956	76%
21	Njoftimi për ankesë në vendimin e KSRL	30				338	27%	926	73%
3	Apeli 2 (instanca e 1)	Paneli i OVGJ	22	Ankesa e kreditorit në O ndaj vendimit të KSRL	270	608	48%	656	52%
			23	Mbrojtja e AKP e dorezuar në OVGJ	30	638	50%	626	50%
			24	Shqyrtimi i OVGJ në lidhje me ankesën	90	728	58%	536	42%
			25	Afati për kreditorin për të dorezuar ankesën e plotësuar	14	742	59%	522	41%
			26	Afati për OVGJ për të shqyrtuar ankesën e plotësuar	30	772	61%	492	39%
			27	Plotësimi i ankesës - së bashku me mbrojtjen dhe përgjigjet	90	862	68%	402	32%
			28	Raporti preliminar i OVGJ në pas përmbylljes së procedurës së shkruar	30	892	71%	372	29%
			29	Urdher nga OVGJ për barren e dëshmise	30	922	73%	342	27%
			30	Aplikimi për vendim të gabueshem	30	952	75%	312	25%
			4	Apeli 3 (instanca e 2)	Apeli i OVGJ	31	Apeli në panelin apeluës të OVGJ	60	1,012
32	Dorezimi i përgjigjes në apel të paneli apeli i OVGJ	60				1,072	85%	192	15%
33	Procedurat e OVGJ për apel dhe përgjigje	60				1,132	90%	132	10%
34	Përgjigja dhe ballafaqimi i paleve në apel	30				1,162	92%	102	8%
35	Palet mund të dorezojnë dëshmi shtese të paneli apeli	15				1,177	93%	87	7%
36	Mbyllja e procedurës së apeli nga OVGJ	30				1,207	95%	57	5%
37	Shpërndarja finale e mjeteve	10				1,217	96%	47	4%
5	Përmbyllja	KL (1 anetar i ICO)	38	Aprovimi i Bordit për përmbylljen e likuidimit	29	1,246	99%	18	1%
			39	Aplikimi në OVGJ për urdher të përmbylljes	15	1,261	100%	3	0%
			40	Njoftimi për Regjistrim të Biznesit për përmbyllje të rastit	3	1,264	100%	0	0%

42 Muaj

Listat e Punëtorëve për 20%

Për shkak të statusit special të punëtorëve të Ndërmarrjeve me Pronësi Shoqërore lidhur me këto Ndërmarrje dhe ndikimin që privatizimi do të ketë në këtë status, punëtorët e kualifikueshëm kanë të drejtë siç përcaktohet me prioritet në pjesën e të ardhurave nga privatizimi dhe likuidimi.


Procesi fillon pasi që shitja e pare e aseteve të NSH-së është kryer me sukses dhe 20% e të ardhurave është lënë anash në fondin e mirëbesimit për punëtorët e kualifikueshëm. Sidoqoftë, procesi aktual është mjaft kompleks dhe i stërzgatur, veçanërisht kur ka të bëjë me shqyrtimin dhe marrjen e vendimit nga OVGJS-ja.

Në esencë, procesi i 20% mund të ndahet në tri faza kryesore siç përshkruhet më poshtë:

Faza e parë


Faza e parë është përgatitja e listës së ashtuquajtur fillestare, e cila është përgatitur nga përfaqësuesit e NSH-së dhe rishikuar nga AKP-ja. Sa më parë që lista fillestare është e gatshme, publikohet në gazeta. Qëllimi është për të lejuar punëtorëve mundësinë për shqyrtimin e listës dhe për të ofruar AKP-së korrigjimet që ata mendojnë se duhen bërë.

Procesi i 20%




Faza e dytë

Faza e dytë është përgatitja e listës përfundimtare pas shqyrtimit të të gjitha ankesave të pranuar lidhur me listën fillestare. Me miratim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, lista përfundimtare publikohet dhe cilado palë e pakënaqur mund t'i adresoj ankesat e saj në OVGJS.



Faza e tretë

Faza e tretë përfshin rishikimin e të gjitha ankesave ndaj listave përfundimtare nga OVGJS-ja. Ndërmjet pranimit të ankesës dhe vendimit të OVGJS-së, Agjencia me miratim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së mund të vazhdoj me shpërndarjen e parakohshme të pjesës së 20% në pritje të vendimit përfundimtar të OVGJS-së.



Nga përmbledhja në vijim do të shihet që vetëm 60 prej 193 listave përfundimtare të parashtruara në OVGJS janë miratuar nga kjo Gjykatë. Do të çmohej që vlera e plotë e të drejtave të punëtorëve nuk mund të lirohet nga AKP-ja derisa lista të miratohet nga OVGJS-ja. Megjithatë, AKP-ja ka iniciuar skemën e shpërndarjes së parakohshme për të lehtësuar vuajtjet e punëtorëve ku pjesa e shumës për tu shpërndarë është paguar dhe deri më sot i tërë totali i paguar nga AKP-ja kap shumën deri në 26 milion euro.


Përmbledhje e Shpërndarjeve për listat e punëtorëve për 20%	AKM (gjatë 6 viteve)	AKP (gjatë 3 viteve)	Totali
Numri i listave të fillestare	41	119	160
Numri i listave përfundimtare	66	127	193
Numri i Listave të miratuara nga OVGJS	59	1	60
Shuma e përgjithshme për tu shpërndarë	21,144,934€	41,204,274€	62,349,208€
Shumat e shpërndara (përfshirë shpërndarjen e parakohshme)	15,657,121€	26,083,131€	41,740,252€
Numri i punëtorëve të paguar (shpërndarja e përfundimtare dhe përkohshme)	9,394	12,918	22,312

Mirëpo vlera e plotë e listave përfundimtare të parashtruara në OVGJS kap shumën deri në 62 milion euro (jashtë të drejtave të përgjithshme të mbi 100 milion euro) dhe 21 milion euro të mbetura nuk mund të lirohen derisa OVGJS-ja të miratoj listat përfundimtare. Gjithashtu do të përmendet që AKP-ja ka finalizuar 127 lista të punëtorëve në 3 vitet ekzistencës së saj dhe kjo krahasohet mjaft favorshëm me 66 lista të finalizuar nga AKM për një periudhë prej 6 viteve. Ky është rezultati i vendimit të matur për politikë 2009 nga AKP-ja për të përshpejtuar procedimin dhe shpërndarjen e të drejtave të punëtorëve.

Analiza përmbledhëse

Aktivitetet kryesore të AKP-së që do të thotë privatizimi, likuidimi, listat e punëtorëve për 20% dhe vendosja e fondeve të mirëbesimit nga AKM-ja gjatë 6 viteve të fundit dhe AKP gjatë 3 viteve të saj është përmbledhur si në vijim:


Privatizimi



Në regjistrin e AKP-së janë 600 NSH, dhe përafërsisht 400 prej tyre janë konsideruar biznese me shanse për sukses ose asete që janë të përshtatshme për privatizim dhe 200 tjera të mbetura që janë ose do të trajtohen përmes procesit të likuidimit.


Me përafërsisht 300 privatizime tani të kryera prej 400 NSH-ve, privatizimi është gati në rrugën e tij për tu përfunduar.

Likuidimi




Me 179 likuidime të filluara dhe shumica më pak se 10% e kryer, ka shumë punë për tu bërë në mënyrë që të kryhet procesi i likuidimit. Dhe mbyllja e rasteve të likuidimit kontrollon shpërndarjen e fondeve tek ankuesit dhe pronarët.

Listat e Punëtorëve të 20%



Në 2 vitet e fundit, AKP-ja ka finalizuar 127 lista mirëpo vetëm një është miratuar nga OVGJS e Kosovës. Ka një nevojë urgjente për reforma në OVGJS të Kosovës për të marrë listat e punëtorëve të miratuara dhe për të mundësuar AKP-në të shpërndaj mbi 60 milion euro për punëtorët e kualifikueshëm.

Fondet e mirëbesimit



Agjencia ka gati 530 milion euro që i mban në mirëbesim që nuk mund ti shpërndaj derisa të kryhen likuidimet me miratim të OVGJS së Kosovës. Ndryshimet e propozuara së fundi për ligjin e AKP-së dhe OVGJS-së do të adresoj vështirësitë dhe liron fondet e mirëbesimit për kreditorët dhe pronarët e ligjshëm, gjë e padryshim do të kontribuoj në ekonominë vendore

Qeverisja Korporative

AKP-ja ka autoritet administrative të gjërë mbi NSH-të siç e parasheh neni 6 i Ligjit për AKP-në. Ky autoritet përfshinë kompetencën për të marrë çfarëdo veprimi që Agjencia e konsideron të arsyeshëm për të ruajtur ose rritur vlerën, shanset për sukses ose qeverisjen e një ndërmarrje. Ky autoritet është pothuajse i gjithanshëm dhe është i detajuar në 19 nën-nene që nuk janë përsëritur këtu. Veç kësaj, neni 7 i Ligjit për AKP-në siguron Agjencisë kompetenca të përgjithshme të menaxhimit të NSH-ve dhe i lejon AKP-së diskrecionin për të lejuar biznesin ditor të NSH-ve për t'u kryer nga trupi menaxhues dhe trupat tjerë të NSH-së pa paragjykim të kompetencave të AKP-së sa i përket privatizimit dhe likuidimit.

Vetë AKP-ja mbledh dhe sistemon të dhënat përfshirë raportet financiare nga NSH-të rregullisht për të mbështetur proceset e privatizimit dhe likuidimit.

Divizioni i Qeverisjes Korporative menaxhon NSH-të të cilat nuk janë nënshtruar privatizimit ose likuidimit.

Gjithashtu monitoron NSH-të të cilat i nënshtrohen kontratave të komercializuara nga e kaluara, përcjell zotimet e investitorit të NSH-së së privatizuar nga AKM-ja përmes metodës së Spinofit Special dhe menaxhon NSH-të që janë nën Administrim Direkt të AKP-së. Përfundimisht Divizioni i Qeverisjes Korporative mbikëqyr operimet e Trepçës.

Siç është cekur në këtë raport është vetëm një NSH që ka mbetur, e cila i nënshtrohet kontratës së komercializimit (Fapol, Podujevë).

Mbikëqyrja dhe kontrolli i NSH-ve akoma të pa privatizuara ose likuiduara ka sjell rastet e dështimit të menaxhmentit në vëmendje të AKP-së dhe në rastet e jashtëzakonshme AKP-ja ka marr kontrollin e ndërmarrjes përmes Administrimit të Drejtpërdrejt. Ku është e mundshme, ndërmarrja privatizohet për të transferuar në sektorin privat dhe në rastet kur nuk ka shpresë të rikthimit, NSH-ja likuidohet. Aktualisht, AKP-ja ka 7 NSH nën Administrim të Drejtpërdrejt dhe të gjitha janë në shqyrtim aktiv për privatizim dhe likuidim në të ardhme të afërt.

Zotimet e përfshira në Spinofet speciale (SOS) në pjesën e investitorëve në kushtet për punësim dhe investime si dhe shumë prej tyre kanë hasur vështirësi që kanë rezultuar me mos përmbushje të kontratës. Siç u cek më lartë AKP-ja nuk e zbaton metodën e privatizimit me spinof special, megjithatë trajtimi i spinofeve speciale të trashëguara ka dëshmuar të jetë jashtëzakonisht kompleks dhe harxhues kohe për menaxhmentin dhe në veçanti për Bordin e Drejtorëve. Komplikimet që kanë ndodhur kryesisht për shkak të kontratave të ashtuquajtura kontrata të përpiluara me përmbajtje të ndryshme për kompanitë nga agjencia paraardhëse dhe veçanërisht për shkak të mos përmbushjes dhe monitorimit neglizhent të AKM-së në plotësimin e obligimeve lidhur me zotimet për investime dhe punësim.

Prej 25 SOS-ave origjinal, 15 i kanë përmbushur zotimet e tyre dhe janë liruar nga monitorimi i AKP-së. Më të suksesshme që vlen të përmenden janë: Ferronikeli, Birraria Peja, Banja e Kllokotit, Fabrika e Tullave IMN, Ballkani, Veraria Rahoveci, Fabrika e Gypave, Tullorja Kamenicë, Mulliri Ferizaj, Fabrika e Farërave, M&Silloso, Modeli etj.

Në anën tjetër të spektrit, Llamkosi nga Vushtrria dështoi në mënyrë spektakolare në vitin 2008 dhe kompania holding e saj nga Bullgaria shkoj në likuidim në vitin 2010 me mbi 1 miliard euro borxh. Dështimi i Llamkosit rezultoi me heqjen e asetëve me shumicë dhe keq menaxhimi që rezultoi me humbjen e 450 vendeve të punës që ishte një goditje e madhe për komunitetin lokal. AKP-ja kthej në posedim Llamkosin në vitin 2010 dhe më pas zgjati kërkimin për një investitor të ri që tani është në fazën e avancuar të sigurimit të investitorëve ndërkombëtar të cilët kanë ekspertizë dhe shkathtësi të marketingut për të vendosur këtë fabrikë të vlefshme në prodhim. Divizioni i Qeverisjes Korporative vazhdon të monitoroj 9 SOS-ave.

Tabela me përmbledhje me detaje rreth SOS-ave është në vijim.

Përmbledhje Gjithëpërfshirëse e Spinofeve Speciale

Nr.	Ndër. e Re	Data	Çmimi i shitjes	Investimet e Zotuara	Vlera sipas auditimit	% e plotësuar	Zotimet për vende pune	Numri sipas auditimit	% e plotësuar
SSO të liruara nga marrëveshja për zotime nga AKM									
1	Perparimi	23/03/2005	1,198,749	2,000,000	2,001,530	100.08%	150	154	102.67%
2	SunflowerOil	26/06/2006	460,000	-	-	-	169	174	102.96%
SSO të liruara nga marrëveshja për zotime nga AKP									
3	Banja e Klokokotit	24/11/2005	1,805,550	3,150,000	3,252,000	103.24%	201	201	100.00%
4	Peja Brewery	29/06/2006	11,130,000	15,206,000	15,234,098	100.18%	612	612	100.00%
5	IMN Brick Factory	28/07/2006	5,689,432	-	-	-	666	667	100.15%
6	Balkan L.L.C	21/07/2005	1,400,000	6,000,000	5,902,277	98.37%	375	375	100.00%
7	Feronikeli	20/04/2006	30,554,371	20,000,000	59,677,464	298.39%	1,000	1,045	104.50%
8	Rahoveci Winery	31/07/2006	4,302,900	5,000,000	4,772,692	95.45%	250	252	100.80%
9	IMK Pipe Factory	20/11/2007	3,657,000	13,200,000	12,488,583	94.61%	360	364	101.11%
10	Tullorja Kamenice	04/06/2008	160,189	-	-	-	81	84	103.70%
11	Mulliri Fabrika e Bukes, Ferizaj	28/04/2008	568,750	5,000,000	4,673,121	93.46%	80	83	103.75%
12	Seed Factory ¹	11/06/2006	201,999	-	-	-	-	-	-
13	FlourMill Fushë Kosova	10/07/2007	2,505,555	15,000,000	14,362,698	95.75%	260	260	100.00%
14	Shpk" M&SILLOSI"	11/05/2005	1,000,000	19,887,564	19,328,797	97.19%	358	367	102.51%
15	Modeli	13/04/2007	630,000	2,200,000	2,040,906	92.77%	170	170	100.00%
SSO ku është ushtruar tërheqja aksionëve									
16	Lamkos Steel LLC	21/07/2005	4,151,000	15,000,000	1,666,265	11.11%	500	500	100.00%
SSO që janë në monitorim									
17	Mimex ²	12/07/2010	103,000	-	-	-	145	145	100.00%
18	Hotel Iliria ³	31/07/2006	1,610,000	3,000,000	5,987,044	199.57%	250	131	52.40%
19	KosovaTex	31/08/2006	3,112,001	4,000,000	4,073,502	101.84%	200	207	103.50%
20	FAN ⁴	23/03/2006	2,310,000	2,800,000	1,808,000	64.57%	236	138	58.47%
21	NBI Suhareka	27/08/2007	4,175,999	8,600,000	4,234,550	49.24%	345	156	45.22%
22	Grand Hotel	13/10/2006	8,160,000	20,200,000	1,244,373	6.16%	540	540	100.00%
23	Xim Stezovci	13/12/2007	730,000	14,300,000	138,073	0.97%	238	11	4.62%
24	Magnezite Mine Goleshi LLC	11/12/2007	810,000	16,200,000	117,570	0.73%	355	58	16.34%
25	IDGJ Tabacco	14/08/2006	1,400,000	5,599,000	1,057,876	18.89%	799	287	35.92%
Total			91,826,495	196,342,564	164,061,419		8,340	6,981	

¹ Nder. e Re Seed Factory si kusht te marveshjes se zotimeve ka pas qarkullimin pre 200.000€, qe do te arrihet si rezultat i prodhimit, perpunimit dhe shitjes se farës

² Punetoret te paraqitur ne tabelen per Nder. e Re Mimex, eshte numri i punetoreve te raportuar nga bleresi per vitin e pare te raportimit qe do te shqyrtohet nga auditimi i jashtem.

³ Punetoret te paraqitur ne tabelen per Nder. e Re Hotel Iliria, eshte numri i punetoreve te raportuar nga bleresi per vitin e pare te raportimit qe do te shqyrtohet nga auditimi i jashtem

⁴ Nder. e Re FAN gjate dy viteve te periudhes se zotimeve ka plotesuar zotimet per punesim ne perputhje me Marrveshjen e Zotimeve.

⁵ Nder. e Re Birraria Pejë gjate dy viteve te periudhes se zotimeve ka plotesuar zotimet per punesim ne perputhje me Marrveshjen e Zotimeve.

Strategjia jonë


Strategjia e AKP-së është të shfrytëzoj mundësinë me përmirësimin e Ligjit për AKP-në dhe të ndërtoj procedura likuidimi që i përshtatet synimit, është në pajtueshmëri me afatet ligjore dhe përshpejton shpërndarjen e të ardhurave tek kreditorët dhe pronarët e ligjshëm si dhe do të bëhen përpjekje të shtuara për të përshpejtuar shpërndarjen e fondeve për punëtorët e kualifikueshëm sipas skemës së 20%.

Plani i gjerë për Agjencinë do të bëjë agjencinë organizatë të udhëhequr nga njerëzit që do të kryejnë privatizimin e të gjitha aseteve me shanse për sukses dhe aranzhon shitjen e çfarëdo aseti të mbetur duke liruar ato për përdorim më produktiv në sektorin privat.

Agjencia do të trajtoj me drejtësi dhe efikasitet ankesat dhe do të punoj në mënyrë efektive me ofruesit e jashtëm të shërbimeve profesionale që do të asistojnë në kryerjen e 600 likuidimeve.

Do të ketë integrim më të mirë të zyrave rajonale dhe zyrës qendrore të Agjencisë me politikat dhe praktika të reja që do të krijojnë kulturë shërbimi për të siguruar që privatizimi dhe likuidimi janë kryer në afat kohor dhe mënyrë efektive. Si pjesë e kësaj çasje, specializimi më i madh i personelit do të bëhet për të përmirësuar rrjedhën e punës dhe rezultatet.

Synimet tjera të ekipit të ri të menaxhmentit përfshijnë sigurimin që zotimet e AKP-së janë plotësuar me marrjen përsipër të ristrukturimit të Agjencisë si dhe fokusin e shtuar në dërgimin e përgjigjeve tek ankuesit në kohë dhe mënyrë profesionale duke ditur shqetësimet e shkaktuara nga vonesat e deritanishme në përgjigjet dhe zgjidhjet e ankesave.



Rregullorja, objektivat dhe dobitë e legjislacionit të ri

Më poshtë janë objektivat strategjike dhe përfitime nga ndryshimevet e legjislacionit përkatës, dmth ligji i ri i AKP-së dhe anekset specifike mbi likuidimet, ligji i ri mbi riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara konsiderohet strategjik për ekonominë e Kosovës dhe ligji i përmirësuar mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës që do të trajtoj në mënyrë ekskluzive çështjet që kanë të bëjnë me AKP-në.

Ligji i ri i AKP-së Historiati ekonomik

Rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës dhe mirëqenia e popullit të saj është e një rëndësie të madhe dhe kërkon administrim, privatizim, dhe likuidim të duhur të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore si dhe në kohë të duhur. Likuidimet e AKP-së nuk janë duke bërë progres. Gjendja e afarizmit nuk është e qëndrueshme. Presioni publik është në rritje për lirimin e fondeve në mirëbesim i cili do të vendos likuiditet të vlefshëm në tregun e brendshëm financiar. Shkatërrimi i mjedisit të vjetër të NSH-së dhe zëvendësimi i saj me sektorin privat që rritet shpejt është nevojë urgjente.

Implikimet sociale

Shpërndarjet për punëtorë, kreditorë dhe ankues është duke ndodhur shumë ngadalë duke kontribuar në vështirësi ekonomike, veçanërisht në papunësi. Transferi i asetëve nga NSH-të në pronësi të sektorit privat do të kontribuoj krijimit të punësimit të qëndrueshëm.

Rezultatet e dëshirueshme të rregullores

Ligji i AKP-së i përmirësuar do të përshpejtoj Privatizimin dhe Likuidimin duke pasur parasysh me objektivat e rregullores së qeverisë si në vijim:

- Përshpejtimi i transferit të asetëve të pashfrytëzuara në sektor privat;
- Përmirëson imazhin publik të Agjencisë përmes transparencës dhe llogaridhënies më të madhe;
- Agjencia do të bëhet më llogaridhënëse ndaj publikut dhe kreditorëve në përgjithësi;
- Përshpejton shpërndarjen e mbi një miliard eurove kreditorëve, ankuesve dhe buxhetit.

Përfundimisht përshpejton mundësinë e investimeve të brendshme dhe të jashtme për investitorët e mundshëm të cilët janë të interesuar në asetet aktualisht në pronësi të NSH-ve kështu duke kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik..

Mjedisi ligjor

Ligji në dalje i AKP-së përmban shtresa të pavolitshme të shqyrtimit dhe ankesat të cilat janë duke shkaktuar pengesa serioze dhe vonesa të mëdha. Këto pa qëllim vonojnë shpërndarjen e të ar-

hurave të mbajtura në llogari për palët e njëjta që kjo strukturë ligjore është dizajnuar për të mbrojtur, dmth ish punëtorëve, kreditorëve dhe pronarëve të ligjshëm. Është jetike që mjedisi ligjor është ripunuar menjëherë për të lehtësuar dhe shpejtuar privatizimin dhe në veçanti procesin e likuidimit duke larguar të gjitha proceset teknike dhe administrative të panevojshme për të mirën e popullit të Kosovës dhe mirëqenia ekonomike e këtij shteti të rij, i cili në esencë është imperativ për tërë ushtrimet dhe gjithashtu Kategorinë Kushtetuese.

Elementet kryesore të ligjit të ri të propozuar

- Ligji i thjeshtësuar i konsoliduar që largon nevojën për referim në materiale të UNMIK-ut;
- Kompetencat e përmirësuara për Agjencinë për të kontrolluar, përshpejtuar dhe administruar privatizimin dhe likuidimin;
- Ristrukturimi i angazhimeve të ZCN-së në Agjenci rezulton me rritjen e përgjegjësisë të Agjencisë për procesin e likuidimit;
- Krijon parime të reja të financimit të Agjencisë me fleksibilitet për të rritur fonde shtesë nga organizatat donatore. Kjo do të zvogëloj në mënyrë domethënëse barrën në Buxhetin e Kosovës dhe e financon Agjencinë duke iu nënshtruar Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;
- Lehtëson paraqitjen e Ofruesve të Shërbimeve Profesionale për të përshpejtuar procesin e likuidimit;
- Kompetencat e përmirësuara për të emëruar ekspertët ligjor dhe të privatizimit pasi që këshilltarët e transaksionit do të bëjnë privatizimin dhe likuidimin më të suksesshëm;
- Zvogëlon afatin kohor të likuidimit prej 42 në maksimum 20 muaj sipas parimeve të Bankës Botërore;
- Mundëson lirimin e hershëm të fondeve në mirëbesim për kreditorët dhe ankuesit me tepricat në buxhet;
- Lidhur me ligjin e ri për riorganizimin dhe rishikimin e ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, ligji i ri i AKP-së do të përfitoj procesi i privatizimit dhe likuidimit dhe do të kontribuoj zhvillimin ekonomik duke rritur llogaridhënien e Agjencisë dhe rrit mirëbesimin e të gjithë palëve të interesit, duke përfshirë edhe kreditorët.

Ligji i ri për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të caktuara

Historiati ekonomik

Trepça aktualisht është duke operuar në shkallë të vogël me të ardhura minimale dhe shpenzime të mëdha (në mesatare 10% të prodhimit historik). Si pasojë, ky grup i minierës krijon humbje të mëdha dhe shpenzime të konsiderueshme në buxhetin e Kosovës si dhe komunitetin e donatorëve. Kjo gjendje e afarizmit nuk është e qëndrueshme.

Ekzistenca e aseteve të minierës në Pjesën Veriore të Kosovës që refuzon të raportoj ose bashkëpunoj me (me përjashtim të pranimit të subvencionet e buxhetit të Kosovës) institucionet e Kosovës është e paqëndrueshëm.

Investime të rëndësishme të nevojshme në dy mini-era dhe shkretore për të implementuar përmirësimet e nevojshme për të rikthyer minierën Trepça dhe operimet metalurgjike.

Mirëpo opinioni i ekspertit tregon që grupi ka rezerva minerale të rikuperueshme të vlerësuara ndërmjet 8 dhe 12 miliard eurove dhe Trepça ka potencial për tu bërë një nga fituesit më të mëdhenj të valutës së huaj në Ballkan.

Implikimet sociale

Fuqia punëtore e minierës është duke plakur shpejt (mosha mesatare është 55 vite). Brenda 3 deri 5 viteve e tërë fuqia punëtore do të jetë e moshës pensionuese kështu që do të humbet një përvojë e vlefshme dhe shkathtësi teknike. Trepça e revitalizuar ka kapacitet për të krijuar vende pune të qëndrueshme (sigurisht punëdhënësi më i madh në vend) duke mos përmendur goditjen e rëndësishme në të mirat e punësimit të dytë dhe ofrimin e shërbimeve të biznesit.

Rezultatet e dëshirueshme të rregullores

Korniza ligjore do të rishikohet dhe ligji i ri i krijuar për të mundësuar revitalizim të suksesshëm të Trepçës duke pasur parasysh objektivat e rregullores së qeverisë:

- Revitalizimi i industrisë së minierës në Kosovë përmes privatizimit/koncesionimit/likuidimit të Trepçës,
- Krijimi i punësimit të qëndrueshëm në tërë vendin,
- Fton investimet e drejtpërdrejta të huaja nga grupet minierave ndërkombëtare me arritje globale, ekspertizë teknike, aftësi investuese dhe kapacitet për të absorbuar koston e pas-trimit të ambientit për të marrë pjesë në revitalizim,

- Krijon mundësi eksportuese fituese dhe përmes këtyre fitimeve të taniemave të rëndësishme për të mirën e buxhetit të Kosovës.

Përfundimisht, krijon mundësinë më të madhe në vend për investim dhe vendos burimet natyrale të Kosovës të punoj për të mirën e Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Mjedisi ligjor

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) është duke luftuar të zgjas vendimin për moratorium lëshuar nga Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës (OVGJS) me datë të fundit Dhjetor 2011.

Ligji aktual i AKP-së i kombinuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/48 (e hartuar për të akomoduar riorganizimin dhe likuidimin e Trepçës) nuk ofron platformë adekuate ligjore për metodologjinë e zbatueshme për të riorganizuar ose ristrukturuar Trepçën.

Është jetike që mjedisi ligjor është ripunuar menjëherë për të lehtësuar privatizim të suksesshëm për të mirën e popullit të Kosovës dhe mirëqenies ekonomike të shtetit tone të ri.

Elementet kryesore të ligjit të ri të propozuar

- Kushte fleksibile të riorganizimit për të tërhequr investitor minierave globale,
- Njohja e ankuesve të vërtetë dhe trajtimi i drejtë i ankesave sipas pikave referuese ndërkombëtare,
- Mbikëqyrja gjyqësore e procesit për të krijuar transparencë dhe shpalosje,
- Përfaqësimi i kreditorit për të siguruar drejtësi, përfitim nga këshillat e jashtme si dhe siguron blerje,
- Kompetencë adekuate për Agjencinë Kosovare të Privatizimit për të kontrolluar dhe administruar procesin,
- Kompetenca të gjëra në emërimin e ekspertëve të minierave, ekspertëve ligjor dhe ekspertëve të privatizimit si këshilltar të transaksionit për të mirën e Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj
- Pagesat me kohë të ankesave në pajtueshmëri me parimet e Bankës Botërore të të drejtave të kreditorëve.

Ligji i ri mbi Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës

Historiati

Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës (OVGJS) është themeluar në vitin 2003 me të vetmin qëllim të gjykimit të rasteve lidhur me vendimet ose veprimet e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM). AKM-ja është shpërbërë në Qershor të vitit 2008 dhe është zëvendësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) e cila është formuar sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Prej fillimit, OVGJS-ja refuzonte të njeh AKP-në si pasardhëse ligjore e AKM-së si dhe nuk njihte Kushtetutën e Kosovës. Marrëdhëniet u bënë më të pareaalizueshme kur Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përhershëm të Kombeve të Bashkuara pretendoj për vete autoritet ekskluziv ndaj çfarëdo çështje që ka të bëjë me AKM-në megjithëse AKM-ja nuk ekzistonte dhe PSSP-ja ishte obliguar të mbështetej në AKP-në dhe të kthente të gjitha të dhënat e AKM-së. Kështu që ishte themeluar nevoja për ndryshim fundamental dhe AKP-ja bënte fushatë për ndryshim që nga zanafilla e saj.

Mundësia për zë zgjedhur rebusin erdhi në mars 2011, kur AKP-ja fitoj një lëndë të pike referuese kundër OVGJS-së në një shkelje "të drejtave të njeriut" në një seancë të Gjykatës Kushtetuese e cila vendosi që mosnjohja e AKP-së nga OVGJS-ja i ka mohuar Agjencisë të drejtën për gjyq të drejtë. Pavarësisht nga problemi i "njohjes", administrata e OVGJS-së është kaotike dhe ka lëndë të pa trajtuara, ku në këtë mënyrë i mohojnë AKP-së dhe ankuesve drejtësinë që ata e meritojnë.

Rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës dhe mirëqenia e popullatës së saj është e një rëndësie të lartë dhe funksionimi efektiv i OVGJS-së është kryesor në privatizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore në kohë të duhur. Gjithashtu ka presion publik për lirim të fondeve të mirëbesimit të Agjencisë të cilat do të fusin likuiditet të vlefshëm në tregun e brendshëm financiar.

Për arritjen e ndryshimit në status dhe funksionimi i OVGJS-së është urgjent.

Rezultatet e dëshirueshme të Rregullores

Ligji i rishikuar i OVGJS-së do të lehtësoj suksesin e privatizimit dhe likuidimit të kryer nga Agjencia duke pasur parasysh objektivat e politikës së qeverisë:

- Përsheptimi i transferit të ndërmarrjeve dhe asetëve në sektor privat
- Ndikimi pozitiv i statusit social të ish-punëtorëve duke përsheptuar shpërndarjen e 20% të të ardhurave nga privatizimi dhe likuidimi i NSH-ve.
- Përforcon llogaridhënien e Agjencisë ndaj publikut dhe kreditorëve në përgjithësi.
- Përsheptimi i shpërndarjes së fondeve në mirëbesim ndaj kreditorëve dhe ankuesve.

Mjedisi ligjor

Ligji për OVGJS-në në dalje përmban afate kohore të gjata që janë duke shkaktuar pengesa serioze dhe vonesa të padëshirueshme të procedurave.

Procedurat e gjata për ankimim ndikojnë negativisht në mbylljen e likuidimeve që në kthim pengojnë shpërndarjen e fondeve në mirëbesim për kreditorët dhe ankuesit.

Punë të pakryera të listave të punëtorëve lidhur me ankesat iu mohohen punëtorëve të NSH-ve të drejtën legjitime në pjesë të procedurave të privatizimit dhe likuidimit.

Është jetike që mjedisi ligjor është rishikuar menjëherë për të lehtësuar privatizimin e suksesshëm për të mirën e popullit të Kosovës dhe mirëqenies ekonomike të këtij shteti të ri.

Elementet kryesore të ligjit të ri të propozuar

- Ligji i konsoliduar i thjeshtësuar që largon nevojën për t'iu referuar materialeve të UNMIK-ut;
- Ndryshon në mënyrë domethënëse në përbërjen e OVGJS-së dhe panelet e saj, në këtë mënyrë rrit prezencën e gjykatësve vendor;
- Rrit numrin e gjykatësve dhe paneleve që merren me rastet e privatizimit dhe likuidimit;
- Rrit dobinë e procedurave duke eliminuar diskrecionin e OVGJS-së për t'iu referuar rasteve të gjykatave më të ulëta;
- Mundëson shqyrtim më të shpejt gjyqësor të kërkesave dhe ankesave duke caktuar afate strikte për seancat e OVGJS-së;
- Përshepton shqyrtimet gjyqësore të sfidave të vendimeve mbi ankesat në likuidim.

Lidhur me ligjin e ri për riorganizimin dhe rishikimin e Ligjit të AKP-së, ligji i rishikuar i OVGJS-së do të përsheptoj privatizimin dhe likuidimin dhe kështu do të kontribuoj zhvillimit ekonomik.

Konkludimet

Privatizimi dhe likuidimi është shtyllë e transformimit ekonomik të Kosovës dhe ky pohim pasqyrohet në kriteret kryesore ekonomike të përmendura në Marrëveshjen për Partneritet me Bashkimin Evropian për Kosovë e cila thotë “ – Në kuptim të plotë avancon privatizimin e ish ndërmarrjeve në pronësi shoqërore në pajtueshmëri me skemën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit”.

Të gjithë indikatorët ekonomik tregojnë që ekonomia e Kosovës është në rritje, trendi i cili nuk kënaq disa nga fqinjët tanë dhe disa vështrues makroekonomik kanë identifikuar procesin e privatizimit dhe likuidimit si një nga stimuluesit kryesor të rritjes së sektorit privat. Kjo informatë është inkurajim i madh për Agjencinë për vazhdimin e punës, kryerjen e privatizimit të aseteve të mbetura me shanse për sukses dhe më pas të përfundoj punën duke liruar të gjitha asetet tjera për punësim në sektorin privat përmes shitjes së aseteve përmes likuidimit. APK-ja fuqimisht beson që ka performuar mire në rrethana të vështira dhe sfiduese dhe për të rritur performansën dhe për të vazhduar me operimet, ka pasur nevojë urgjente për identifikimin e shkaqeve të privatizimit të ngadalshëm dhe likuidimin e stopuar i cili ka krijuar zemërim të drejtë në mesin e kreditorëve dhe ankuesve si dhe veçanërisht punëtorëve të pa punësuar me kërkesa të vlefshme për 20% të cilët nuk janë paguar brenda afatit të arsyeshëm kohor.

Problemet dhe zgjidhjet e tyre

Gjatë dy viteve të fundit, AKP-ja ka qenë në fokus të studimeve, vështrimeve, komenteve dhe rekomandimeve të numërta nga ekspertë të pavarur. Privatizimi është konsideruar të jetë shumë i ngadalshëm dhe kritika ishte nivelizuar në paraardhësin e AKP-së si rezultat. Ky reputacion ishte trashëguar nga AKP-ja megjithëse ishte i pamërituar pasi që AKP-ja njohu vlefshmërinë e kësaj kritike dhe ka përshpejtuar procesin e privatizimit. Mirëpo kjo iniciativë dëshmoi një detyrë më të vështirë për të kryer pasi AKM-ja privatizoi ndërmarrjet më atraktive dhe më të mëdha dhe AKP-ja tani është duke trajtuar rastet problematike siç janë ndërmarrjet me dokumente të pronësisë të dyshimtë ose pa dokumente fare, bizneset që kanë humbur tregjet e tyre ose aftësitë punuese për arsye se kanë qenë në jo-aktive për vite të tëra. Pavarësisht kësaj, AKP-ja ia ka dal mbanë në rrethana të vështira.

Likuidimi ka dëshmuar të jetë problemi më i madh. Ka marr shumë kohë për të kuptuar burimin e vërtetë të vështirësisë e cila ka dëshmuar të jetë ligji qeverisës dhe metodologjia për likuidim e dizajnuar keq. Ligji i AKP-së 2008 përmbante nivele të shumta

të shqyrtimit dhe ankimit që shkaktonin pengesa serioze dhe vonesa të mëdha. Përveç kësaj gjendje, ritmi i ngadalshëm i procedimit të rasteve ligjore në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme përmbledh problemet që çojnë pranë kolapsit të procesit të likuidimit. Në mënyrë ironike, ky kombinim i problemeve rezultoi me mohimin e drejtësisë për njerëzit për të cilët këto ligje ishin dizajnuar për ti mbrojtur, pra kreditorët dhe pronarët e ligjshëm.

Janë përgatitur tri ligje të reja për të adresuar rebusin e likuidimit, ligji i ri i AKP-së, Ligji i ri për Riorganizim dhe ligji i rishkruar për Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme. Këto ligje të reja do të krijojnë kornizë ligjore të punëshme për të përshpejtuar likuidimin dhe i ofrojnë Agjencisë mjete për të filluar shpërndarjen e fondeve në mirëbesim të pronarët e ligjshëm.

Këto ndryshime të domosdoshme në legjislacionin aktual janë kërkuar për të mundësuar funksionimin e duhur të AKP-së dhe OVGJS-së së Kosovës të cilat pa dyshim do të përshpejtojnë tërë procesin e privatizimit dhe posaçërisht likuidimin së bashku me shpërndarjen e 20% për punëtorët e kualifikueshëm. Kjo do ti lejoj AKP-së përmbushjen e mandatit të saj brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Vizioni

Bordi i Drejtorëve mbetet përgjegjës për lidërsipin dhe drejtimin e AKP-së si dhe është përgjegjës ndaj palëve të interesit për të gjitha performansat e AKP-së. AKP-ja do të shfrytëzoj nismën dhe mundësinë e krijuar nga korniza e re ligjore si dhe do të përshpejtoj privatizimin dhe likuidimin. Për më tepër, pritet që OVGJS-ja e Kosovës të jetë më e kujdesshme në trajtimin e rasteve ligjore dhe posaçërisht miratimet e listave të punëtorëve.

Në fund, synimi i përgjithshëm mbetet për të siguruar që mësimet e mësuara në kohët e fundit janë implementuar në mënyrë gjithëpërfshirëse. Ne e kuptojmë që në të ardhmen e afërt AKP-ja do të bëhet organizatë më e vogël, mirëpo shumë profesionale që rezultojn me performansë të përmirësuar dhe kosto të zvogëluar.

Unë mund të ju siguroj që Bordi i Drejtorëve të AKP-së, Menaxhmenti i AKP-së dhe personeli i saj janë të përcaktuar për të bërë çdo gjë që është e mundur për të përmirësuar dhe mirëmbajtur besimin e të gjitha palëve të interesit në AKP. Transparenca është shtylla e demokracisë dhe ekonomisë së tregut.

Dino Asanaj
Kryetari i Bordit të Drejtorëve



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

www.pak-ks.org